



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI KOMBËTAR I UJIT

V E N D I M

Nr. 1 Datë 16.04.2004

**“PËR MIRATIMIN E STRATEGJISË
KOMBËTARE TË UJIT PËR SHQIPËRINË”**

Në mbështetje të nenit 6, pika a dhe të nenit 9 të ligjit nr.8093, datë 21.03.1996 “Për rezervat ujore” dhe të rregullores së funksionimit të K KU-së pika 5.4, paragrafi 5, me propozim të Ministrit të Rregullimit të Territorit dhe Turizmit, Këshilli Kombëtar i Ujit

VENDOSI :

1. Të miratojë “Strategjinë Kombëtare të Ujit për Shqipërinë” bashkëlidhur këtij vendimi.
2. Ministritë dhe institucionet e lidhura me përdorimin e rezervave ujore, jo me vonë se një herë në 3 vjet, të bëjnë analizë të ecurisë së zbatimit të strategjisë dhe të propozojnë në Këshillin Kombëtar të Ujit dhe në Këshillin e Ministrave projektaktet përkatëse.
3. Ngarkohen Ministria e Rregullimit të Territorit dhe Turizmit, Ministria e Mjedisit, Ministria e Bujqësisë dhe Ushqimit, Ministria e Industrisë dhe Energjetikës, Ministria e Financave, Ministria e Ekonomisë, Ministria e Pushtetit Vendor dhe Decentralizimit dhe Akademia e Shkencave për zbatimin e këtij vendimi.
4. Ngarkohet Ministri i Rregullimit të Territorit dhe Turizmit të propozojë në Këshillin e Ministrave projektvendimin në mbështetje të këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI

FATOS NANO